

VENDIM
Nr. 152, datë 12.11.2012

PËR RISHIKIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 68, DATË 23.6.2008

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii”, 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me nisjen e procesit të rishikimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike,

VENDOSI:

1. Në kapitullit X të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të shtohet pika 2, me përmbajtjen si vijon: “Çdo pjesëtar i tregut, që ka përgjegjësi për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, kur argumenton që rrezikohet siguria e furnizimit me energji elektrike e konsumatorëve fundorë, mund të bëjë kërkesë në ERE, që Bordi i Komisionerëve të alokojë me të drejta të siguruara kapacitetet e lira të muajit pasardhës, pa cenuar të drejtat e rezervuara në ankandet vjetore.

Bordi i Komisionerëve do të vendosë rast pas rasti, për periudha jo më të gjata se një muaj, mbi bazë të argumenteve të paraqitura në kërkesë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a., OST sh.a., “CEZ Shpërndarje” sh.a. dhe shoqatën AEES, për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani